



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 9451 Prot.

Fier, më 18.08 2025

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER

PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier në sallën e këshillit ditën e **Enjte datë 28.08.2025 në orën 11:00** me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **31.07.2025**.
3. Projekt – vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Korrik 2025".

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.

4. Projekt – vendim: "Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)".

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

5. Projekt – vendim: "Për miratimin e kërkesës së shoqërisë "Veko" sh.p.k. për dhënien e të drejtës së kalimit "Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore së transmetimit të energjisë elektrike" në pronat e Bashkisë Fier".

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

6. **Projekt – vendim:** “Për shtyrje e afatit të kontratës së marrjes me qira të sipërfaqes truall , në Zonën Kadastrale Nr.8531, për pasuritë Nr.8/2;8/4 me sipërfaqe totale 3,466 m² për ndërtimin e tregut të produkteve bujqësore dhe blegtorale, miratuar me VKB nr. 74 datë 27.09.2016, pika 2 e kësaj VKB”

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

7. **Projekt – vendim:** “Për heqjen detyrimeve të prapambetura të cilat janë të pasqyruara në kontabilitetin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për arsye se mungon dokumentacioni për të bërë të mundur ekzekutimin e tyre”.

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

8. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjen e pastrehë , që kërkon të përfitojë nga subvencionimi i qirasë në tregun e lirë dhe nuk ka të ardhura për të përballuar vlerën e qirasë”.

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.

9. **Informacion Këshillit :** “Mbi vlerat e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe vlerësuara nga komisionet përkatëse gjatë kryerjes së inventarizimit 2024, të aparatit të Bashkisë Fier si dhe të disa Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Fier.

10. Diskutime dhe komente.

**Kryetar Këshilli
Antoneta Çunaj**

